

Më datë 31 Janar 2022, Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Projekteve me Financime të Huaja, në zbatim të urdhrit nr. 8 datë 18.01.2022 “Për kryerjen e analizës vjetore të veprimtarisë së Departamenteve të KLSH-së për vitin 2021”, ka zhvilluar në mjediset e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, analizën vjetore mbi aktivitetin për vitin 2021.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Arben Shehu, Drejtori i Përgjithshëm znj. Marjola Llanaj, Drejtori i Departamentit z. Ryisim Xhaja, Rektori i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan z. Skënder Topi, si dhe stafi auditues i këtij Departamenti.

Analiza vjetore filloi me fjalën hyrëse të Rektorit të Universitetit z. Topi i cili falenderoi Kryetarin e KLSH z. Shehu mbi përzgjedhjen e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” për kryerjen e kësaj analize vjetore, si një mundësi e mirë për njohjen nga stafi i Universitetit të rezultateve të punës nga një institucion si Kontrolli i Lartë i Shtetit. Gjithashtu, nga ana e Rektorit u theksua domosdoshmëria që ka jo vetëm kryerja e analizave vjetore në një mjedis si Universiteti, por u kërkua gjithashtu edhe mundësia e kryerjes së takimeve me qëllim ndarjen e eksperiencës së përftuar nga ana e audituesve me studentët ekselentë të këtij Universiteti.



Në vijim fjalën e mori z. Shehu nga ana e të cilit u shprehën falënderime për mundësimin nga ana e Rektorit të UE të kryerjes së analizës në një institucion arsimor siç është Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, bashkëpunimi me të cilin konsiderohet një vlerë e shtuar për punën që kryen Kontrolli i Lartë i Shtetit. Më tej, Kryetari i KLSH falënderoi stafin për rezultatet e arritura duke theksuar rëndësinë që ka vendosja e prioriteteve individuale për çdo auditues, me qëllim rritjen profesionale dhe të kapaciteteve audituese.

Më tej, fjalën e mori Drejtori i Përgjithshëm znj. Mariola Llanaj, e cila falënderoi stafin për punën e kryer si dhe kujtoi rëndësinë që ka përmirësimi i punës së gjithë secilit në rritjen e cilësisë së auditimeve.

Më pas u vijua me përmbledhjen e veprimtarisë audituese të Drejtorit të Departamentit z. Rysisim Xhaja, i cili u përqendrua fillimisht në statistikat vjetore për plotësimin e programit vjetor të auditimit, rezultatet e tyre të shprehura në rekomandime për përmirësime e ndryshime ligjore, masat organizative, administrative dhe disiplinore, masat për shpërblimin e dëmit dhe përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve së bashku me vlerën e tyre si dhe rastet dhe numri i kallëzimeve penale. Gjithashtu, gjatë analizës u prezantuan disa prej auditimeve të kryera gjatë vitit 2021 nga ana e audituesve Jonild Hoxhaj, Artan Topjana, Ina Sokoli dhe Blerin Shkurti.